



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN  
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI"

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt	20.02.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-51

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Këshilli Drejtues

Nr. ref. \_\_\_\_\_

\_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_.

Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" në mbledhjen e mbajtur me datën 30.01.2019, duke u bazuar në dispozitat e Statutit të UUHP-së nr. 04-V-621 dhe rregullores nr. 01-218 mori vendim për të shpall:

### KONKURS

#### Për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2016/17 dhe 2017/18

Përfitues të bursës universitare do të jenë vetëm studentët e UUHP-së, niveli beçelor i studimeve (themelore), të cilët i plotësojnë kriteret si në vijim.

- Student në njërin prej fakulteteve në Universitetin "Ukshin Hoti";
- Student i vitit të dytë (e më lart), si dhe të mos ketë vit të përsëritur të studimeve;
- Ti ketë të përfunduar të gjitha provimet e vitit paraprak të studimeve në afatin e shtatorit;
- Të ketë notë mesatare të paktën 9.0 nëntë pikë zero (për vitin që aplikon por edhe mesatarja e përgjithshme të mos jetë nën notën 9.0 deri në shtatorin e vitit për të cilin aplikon).

#### Dokumentacioni për aplikim:

- Formulari i aplikimit;
- Pasqyra e notave;
- Vërtetimin;
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Numrin e llogarisë bankare.

Lartësia e bursës do të caktohet varësisht nga numri i studentëve përfitues të bursës.  
**Vërejtje:** Studentët me rastin e plotësimit të formularëve të aplikimit duhet të saktësojnë për cilin vit akademik aplikojnë; nëse aplikojnë për vitin 2016/17 dhe 2017/18 duhet ta deklarojnë në formular dhe dorëzojnë vetëm një dosje aplikimi.

**Afati i aplikimit është 20.02.2019 - 07.03.2019.**

Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zyrën nr. 526 administrata qendrore- zyra e personelit.  
Formularët për aplikim gjenden në faqen zyrtare të UUHP-së: **www.uni-prizren.com**